

gendra  
multimedia

ANTOLOGJI E DRAM  
E DRAMËS  
NE BASHKËKOHORE  
ËKOHORE SLOVENE

Dushan Jovanoviç  
Evald Flisar  
Drago Jançar  
Vinko Mōderndorfer  
Simona Semeniq






---

# traduki

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integritit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zviceran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S. Fischer.

## BASHKË-FINANCUAR NGA:



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

---

---

# ANTOLOGJI E DRAMËS BASHKËKOHORE SLLOVENE

Përktheu nga sllovenishtja: **Nikollë Berisha**

- **Dushan Jovanović**
- **Evald Flisar**
- **Drago Jančar**
- **Vinko Möderndorfer**
- **Simona Semenik**

Prishtinë, 2021

---

---

# ANTOLOGJI E DRAMËS BASHKËKOHORE SLOVENE

- Dushan Jovanoviq (Dušan Jovanović)
- Evald Flisar (Evald Flisar)
- Drago Jançar (Drago Jančar)
- Vinko Möderndorfer (Vinko Möderndorfer)
- Simona Semeniq (Simona Semenič)

**Përktheu nga sllovenishtja:** Nikollë Berisha

**Redaktor i botimit:** Jeton Neziraj

**Lektura:** Rexhep Ukelli

**Përgatitja për botim:** Aurela Kadriu

**Botues:** Qendra Multimedia, Prishtinë  
[www.qendra.org](http://www.qendra.org) / [info@qendra.org](mailto:info@qendra.org)

- © për këtë botim: Qendra Multimedia, Prishtinë
- © për dramën "Klinika Kozarcky": Dushan Jovanoviq
- © për dramën "Nora Nora": Evald Flisar
- © për dramën "Valsi i madh brilant": Drago Jançar
- © për dramën "Romeo dhe Zhulieta ishin refugjatë":  
Vinko Möderndorfer
- © për dramën "5 djelmoshat.si": Simona Semeniq

**Dizajni dhe thyerja grafike:** project.graphics

**Shtypi:** Printing Press

---

---

# PËRMBAJTJA

- 06 DY FJALË NË  
VEND TË HYRJES
- 08 KLINIKA KOZARCKY  
nga Dushan Jovanoviq
- 90 NORA NORA  
nga Evald Flisar
- 188 VALSI I MADH BRILANT  
nga Drago Jançar
- 286 ROMEO DHE ZHULIETA  
ISHIN REFUGJATË  
nga Vinko Möderndorfer
- 400 5 DJELMOSHAT.SI  
nga Simona Semeniq
-

# DY FJALË NË VEND TË HYRJES

Përçarjet ndërmjet intelektualëve, e me këtë edhe shoqërisë slovene, atëbotë pjesë e perandorisë së madhe Austro-Hungareze, u shfaqën dukshëm pas paraqitjes së iluminizmit në Evropë, që definoi Rilindjen kombëtare slovene. Pansllavizmit si ide udhëheqëse e Romantizmit të vjetër (intelektualët konservativë) iu kundërvu ideja e Romantizmit të ri, të udhëhequr nga Matija Čop (poliglotti që i fliste 19 gjuhë, në mesin e të cilave edhe gjuhën shqipe) dhe poeti kombëtar sloven, France Presheren (1800-1849). Me këta dy autorë u vunë bazat e letërsisë slovene, por edhe të dramatikës slovene. Shtysë të posaçme letërsisë, e me të edhe dramatikës slovene i jepet me përçarjen tjetër, pas vitit 1866, kur intelijenca serish ndahet në dy grupe, në “slovenët e vjetër” dhe “slovenët e rinj”. Ishin këta të dytit që vazhduan veprën e romantizmit të ri duke bindur lexuesit, se përkundër idesë së grupit tjetër, në gjuhën slovene mund të shkruheshin krijime artistike të nivelit më të lartë. Me krijimin e “Amëzës slovene” / *Matica slovenska* (1864) që mbliidhte rreth vetes intelektualë, poetë, prozatorë me një ndjenjë të lartë nacionale slovene, të cilët, disa vjet më vonë (1867) krijuan Shoqata e Dramës / *Dramatično društvo* edhe definitivisht u njoh krijimtaria artistike dramatike ndër slovenët, veçanërisht me përfaqësuesin e saj kryeso, Fran Levstik.

Me qëllim e bëra një vështrim të shkurtër historik, sa për të krijuar një pasqyrë sado të qartë, se zhvillimin e kësaj dramatike, me histori gati dy shekuj të gjatë, me përfaqësues që nga Preshereni (Krst pri Savici, që sipas kritikës letrare është poemë me elemente të dramës), I. Cankari (*Za narodov*



blagor, Kralj na Betajnovi, Pohujšanje v dolini Šentflorjanski dhe Hlapci) e deri te autorët e fundit të shekullit XX, si Gregor Strnisha, Peter Bozhiç, Dane Zajc, Slavko Grum, Rudi Sheligo e bashkëkohorë të shumtë të tyre, pa i kapërcyer edhe autorët më të rinj, tekstet dramatike të të cilëve janë pjesë e rregullt repertorit të skenave më të njohura botërore të dramës, është vështirë ta përmbledhësh në një pasqyrë. Pavarësisht se përpilimi i çdo pasqyre të një lloji letrar të një kombi mban, padyshim, vulën subjektive, gjë që e ndjeva edhe gjatë përpilimit të “Antologjisë së poezisë bashkëkohore sllovene”, të botuar në Toena, Tiranë, më 2008, parimi kryesor i përzgjedhjes ishte të prezantoja prodhimet më reprezentative (dhe njëkohësisht autorët më reprezentativë) që e përcaktojnë këtë lloj letrar ndër sllovenët.

Ndihmë shumë e madhe ishte edhe ekzistimi i të ashtuquajturit “Çmimi i Grumit” (sipas dramaturgut të njohur slloven Sllavko Grum). Çmimi i Grumit është çmim për tekstet më të mira dramatike gjatë një viti në hapësirën kulturore sllovene, që ndahet që nga viti 1979 në kuadër të Javës së dramës sllovene. Organizator i këtij manifestimi është Teatri i Preshernit / Prešernovo gledališče në Kranj. Të drejtën e kandidimit me shfaqje (një ose më shumë sosh) kanë të gjitha teatrot apo grupet jo të përhershme teatrore sllovene, por gjithsesi, vlerësohet teksti, e jo interpretimi. Deri më tani janë vlerësuar me këtë çmim 47 drama sllovene, në mesin e tyre edhe pesë autore të dramave, që po i paraqesim këtu.

Dramat që i përzgjedha për këtë botim, përpos asaj të Dushan Jovanoviqit ishin vlerësuar me këtë çmim. Drama e Jovanoviqit, edhe pse ai është laureat i katërfishtë i këtij çmimi, ishte zgjedhje e tij.

## **Përkthyesi**

---

DUSHAN JOVANOVIQ

**KLINIKA  
KOZARCKY**

---

---

## PERSONAZHET:

**EMILI**, pacient, një burrë me përkrenare, duket si tridhjetë e shtatë vjeç, ndonëse me siguri është më i ri;

**VINKOJA**, pacient, burrë me kapele të skijimit, duket si tridhjetë e shtatë vjeç, ndonëse me siguri është më i ri;

**FRANCKA**, bashkëshortja e tij, tridhjetë e një vjeçe;

**MOJCA**, motra e saj binjake, tridhjetë e një vjeçe;

**LOJZKA**, kameriere, bionde, njëzet e pesë vjeçe;

**BERTA**, motra e saj, police, njëzet e pesë vjeçe;

**DOLLARI**, pronari i kafenesë, një burrë me kapele jordaneze, duket si tridhjetë e pesë vjeç, ndonëse me siguri është më i ri;

**BABA I DOLLARIT**, burrë me çifte, duket diç më i vjetër se tridhjetë e pesë vjeç, ndonëse do të duhej të ishte shumë më i vjetër;

**DR. KOZARCKY**, shefi i klinikës, tridhjetë e katër vjeç;

**GORJANCI**, drejtori, njeriu me kapele republikë, dyzet e dy vjeç;

**JUNIORI**, vëllai më i ri i Gorjancit, dyzet e dy vjeç;

### **KAMERAMANI**

Vërejtje:

1. Çiftet: FRANCKA-MOJCA, LOJZKA-BERTA, GORJANCI-JUNIORI, DOLLARI-BABA I DOLLARIT, e luan aktori-aktorja e njëjtë.
  2. Fjalimi i DR. KOZARCKYT është i ngjyrosur me polonishte.
-

## TABLOJA E PARË

*(Jesenice, një kafene e dorës së tretë në periferi.*

*Mëngjes.*

*Hyn dr. KOZARCKY dhe i drejtohet publikut.)*

**DR. KOZARCKY:** Mirëmbërëma, zonja dhe zotërinj! Quhem dr. Janusz Kozarcky. Në vitin 1963 më lindën në kryeqendrën e Mongolisë, Ulan Bator. Ojçjeci im punonte atje si “schef de la cuisine” në Ambasadën poloneze. Njeri i mirë, por edhe ithtar i pasionuar i vodka vyborowas. Në gjendje jo të dehur e takoi, e njohu dhe e martoi matkën time, shtetasen sovjetike, me prejardhje japoneze, pra ajo punonte në FAO si këshilltare profesionale në projektin e rritjes së kuajve në stepë. Një femër e florinjte, por, për fat të keq, edhe ajo - me trup dhe me shpirt i ishte dorëzuar rakisë së orizit. Si pasojë e cakërrimit të gjatë të dy gotave, gotës së sakesë me gotën e vodka vyborowas, erdha unë në këtë botë, Janusz Kozarcky.

Zyrtarisht unë isha djali i vetëm, ndonëse baba dhe matka përpos meje fshehtazi e kishin jeshçe një fëmijë. Ky ishte vëllai im, Alkooli. Bardzo, isha xheloz në vëllain tim, ngase më dukej se atë prindërit e donin më shumë se mua. Çdo mbrëmje me tërë shpirt e lusja Zotin, që ta marrë me vete në qiell. Mirëpo pan Zoti, nuk i pa lotët e mia, as e dëgjoji dënesën time. Për këtë arsye vendosa që vëllain tim dyfytyrësh ta vrisja unë vetë. U betova: kjo krijesë të avullohet sa më parë nga familja jonë! Kështu, si fëmijë, e zbulova kuptimin e jetës sime, dhe u vendosa për profesionin të cilin edhe sot e kryej me ndershmëri!

Në vitin 1978 doktorova në psikiatri. Thënë haptazi, teza ime e doktoratës *Mbi vrasjen e vëllait* në qarqet profesionale shkaktoi bardzo - reaksione kontroverse. Disa më ngrinin në qiell, të tjerët më sulmonin me ngulm. Djenki Zotit, pacientët e pranuan këtë me dashamirësi.

Kjo dashamirësi më shtyn gjithnjë përpara. Jetoj nga dashamirësia e atyre që vendosën ta vrasin sëmundjen e vet, ta likuidojnë vëllain e vet.

Si e testova, e avancova dhe e zhvillova metodën time “Kozarcky”? Fillimisht e shërova ojcjin dhe matkën, është kjo gjëja më e vogël që mund ta bëjë për prindërit e vet një njeri normal: t’ua vrasë kopilin e tyre. Pas një pune të shkurtër, porbardzo të suksesshme në vendin e minierave Katowice, ku para ardhjes sime çdo i pesti (banor) ishte alkoolik, më ftuan në Halle, qendrën më të madhe të industrisë metalurgjike dhe petrokimisë në Gjermaninë Lindore. Katërqind e tetëdhjetë mijë banorë, prej tyre dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë alkoolikë! Aty e fitova pseudonimin “Der Wundermacher” - çudibërësi. Në bazë të këtyre sukseseve, ftesat për mua vinin si shiu. Ndërmjet viteve ‘91 dhe ‘97 në Evropën Lindore i hapa disa klinika për *vrasjen e vëllait dhe vrasjen e kopilëve* sipas metodës “Kozarcky”: në Rostock, Novosibirsk dhe Vilna, në Maribor, Temisvar, Tashkent, Tetovë dhe në Brçko, në Krapinë, Kaposvar, Kragujevc dhe tani së fundmi edhe në Jesenice. Kjo është klinika e dytë në Slloveni. Sllovenia është një vend i bukur: pak banorë, pak pijanecë. Jam krenar që shërbej te ju!

Dhe cila është fshehtësia e metodës “Kozarcky”? Fshehtësia, miqtë e mi, qëndron në njohjen se vrasja çliron. Der Mord macht frei; pra nëse dëshirojmë të çlirohemi, duhet të vrasim. Pra: vrasje- po, por- si? Duhet të vrasim me ndjenjë të një gëzimi të çliruar; me një buzëqeshje në fytyrë! Me një lehtësi! Me gëzim! Si në shaka! Sikur të mos ndodhte asgjë! Këtu qëndron çelësi! Vrasësi im i vëllait nuk duhet të jetë i mërzhitur as para vrasjes, as gjatë vrasjes e as pas vrasjes! Ideale do të ishte sikur të mos e dinte aspak se e ka vrarë vëllain, ndonëse ky i fundit është i vdekur klinikisht. Për këtë arsye ai edhe më tutje e vret me kënaqësi qoftë edhe tërë jetën e vet. Nëse ti i thua vrasësit që nga sot e tutje nuk ke

më vëlla, nuk ke çka të vrasësh më, atëherë fillon të kthehet mbrapsht. Jeta bëhet absurde. E çka drejtin të bëjë më në këtë botë, nëse nuk guxon të vrasë? Vrasësi që nuk është më vrasës është person i cunguar. Shërimi tradicional e bën vëllavrasësin: ose një leckë të pavlerë ose një njeri neurotik. Variant të tretë es gibt nicht! Dhe këtij i thuhet rehabilitim! E shkatërrojnë njeriun- këtë e bëjnë! Ia falin mëkatën për vëllavrasje, mirëpo tërë jetën duhet të turpërohet dhe të pendohet, që të kishte ndopak vëlla. Çdo alkoolik, mik, e ka dinjitetin e vet. Nuk guxojmë ta shkelim! Alkooliku, miku, e ka zemrën e vet! Nuk guxojmë t'ia shkulim nga gjoksi! Alkooliku, miku, i ka ëndrrat e veta, në zhargonin psikiatrik i quajmë- fantazma; nuk guxojmë t'ia marrim! Alkooliku është njeri i mirë. Vetëm njeriu i mirë duron dhe vetëm ai ka vëlla që mund ta vrasë! Njeriu i poshtër kënaqet në baltin e poshtërsisë së vet. Njeriu i poshtër nuk ka probleme, njeriu i poshtër është i suksesshëm. Shikoni pak përreth vetës dhe pyeteni veten- Ktori, njeri i suksesshëm është njeri i mirë? A njihni ndonjë sish? Nëse po atëherë ky është përjashtim që e vërteton rregullin se në kulm vijnë ata që kanë shkelur përmbi shpinën e të munduarve. Alkoolizmi është ekstrakt i dhimbjes shpirtërore. Këtë e shoh kur i analizoj klientët e mi të dashur, se ata edhe nuk lodhen aq shumë për pije sa për guxim, për vetëdije, për kënaqësi jetësore, për ndjenjë të sigurisë të cilën kjo pije dehëse ua jep qenieve në ankth. Dhe kështu erdha deri te njohuria logjike, miqtë e mi të dashur: të ndërpritet pija, të vritet vëllai, por të ruhet dinjiteti, vetëdija dhe gëzimi jetësor i klientëve të mi.

Dhe si e arrita këtë? *(Cingëron telefoni, Lojzka e ngre dëgjuesen.)* paramendojeni të shkojmë në parkun nacional "Trigllav" dhe nga shkëmbinjtë e maleve të thepisure të nxjerrim luleborat! A do të rritej kjo lule aq e bukur në një vazo për lule në ballkonin e banesës sonë në këtë qytet të hekurit? Jo, nuk do të rritej, apo jo? Mund ta vendosim në dheun më të mirë, ta vadisim, ta plehërojmë, t'ia lëshojmë muzikën e Schopinit, krejt kjo është e kotë- do të përkulet

dhe në fund do të thahet! Pra, pikësëpari: të varurim nga alkooli, nuk guxojmë ta shkulum nga mjedisi i tij i natyrshëm! Dhe cili është mjedisi i natyrshëm i pijanecit? Kuptohet, kjo është kafeneja. Aty është kamerierja e tij, aty janë kameradët e tij të pijes, aty janë të gjitha pijet e tij, gotat e tij, aty i mbështetur në banakun e tij të vjetruar, e ndien veten si në shtëpi. Ligji i parë i metodës “Kozarcky” thotë: klinika është aty ku është alkooliku. Apo thënë ndryshe: klinika është kafeneja! Klinika-kafene; kafeneja-klinikë (*Lojzka i afrohet në mënyrë diskrete Kozarckyt dhe diçka i pëshpërit në vesh.*) Për hir të Zotit, le të thërrasë më vonë!

**LOJZKA:** (*Duke kërkuar falje.*) Është urgjente, është e domosdoshme, nuk mund të presë...

**DR. KOZARCKY:** Po nuk mund ta ndërpres ligjëratën në mes të saj.

**LOJZKA:** Është fjala për nënën tuaj, doktor!

**DR. KOZARCKY:** (*Me dëshpërim.*) Ah, matka, matka, pse më duhet tani të jem unë matka jote kur je ti matka ime?

*(Dr. Kozarcky largohet me vrull, në kafene hyn Emili me përkrenare në kokë dhe me një thes të madh letre. Fytyrën e ka të bardhë nga mielli. Kërcen me nervozizëm, ecën, u fryn gishtave.)*

**LOJZKA:** Mirëmëngjesi, Emil!

**EMILI:** Një të gjelbër! (*Emili me plot vullnet i pi të dy gotat.*) Brrrr, çfarë acari është (*E vendos thesin mbi banak.*) ja, somunet! Janë ende të ngrohta!

*(Lojzka menjëherë e kafshon somunen e vet, hyn Vinkoja me qese plastike në dorë. Duke çaluar drejtohet nga tryeza, ulet. Shfryn. Nga qesja i merr pantoflat, i gjuan në tokë dhe fillon të zbathet. Emili, i mbështetur në banak, e shikon.)*

**LOJZKA:** *(Me gojë plot.)* Mirëmëngjesi, Vinko, sot nuk do të pickosh gjë?

**VINKOJA:** Ngadalë të pushoj pak.

**LOJZKA:** Ah, si je ti!

**VINKOJA:** *(I mërzitur.)* Nuk është çdo njeri i mirë për gjithçka. Unë për shembull di të ziej, por nuk di ta rregulloj makinën!

**EMILI:** A ende e ke “Fiqën”?

**VINKOJA:** A nuk të thashë se më është prishur?

**EMILI:** Dhe tani vozitesh me autobus!

**VINKOJA:** Por më ka humbur bileta mujore!

**EMILI:** Po ti e ke biçikletën!

**VINKOJA:** Rrota i është prishur, e ngava dhe në moment i plasi e brendshmja.

*(Vinkoja i fut këpucët në qese dhe i mbath pantoflat, qesen e varë në varëse. Pastaj e varë edhe kapelën, por menjëherë ndërro mendje dhe e vë kapelën në kokë.)*

**EMILI:** Mirë që shkon këmbë në punë?

**VINKOJA:** Gjuri diçka po më dhimb. Meniskusi!

**EMILI:** A po! Je në pushim mjekësor...

**VINKOJA:** Nuk japin! Mjeku thotë: keni të drejtë për pushim nëse bëni operacion!

**EMILI:** Po edhe bashkëshortja e ka makinën, apo jo?

**VINKOJA:** *(I inatosur.)* E ku do të arrija unë në jetën time sikur ta prisja bashkëshorten, Francka nuk ka kohë as për veten!



**EMILI:** E pse vjen atëherë në kafene?

**VINKOJA:** Nuk e kam idenë! Vetëdijesohem vetëm kur jam pranë banakut!

**LOJZKA:** *(Shikon nëpër dritare.)* Francka! *(Vinkoja e merr qesen dhe këpucët dhe ikën në nevojtoje. Hyn Francka.)* Francka nuk është këtu?

**EMILI:** Jo.

*(Francka largohet, Vinkoja del nga wc-ja dhe e shikon përkrenaren e Emilin.)* Ku e fitove atë përkrenare?

**EMILI:** Ma bleu Angela. Para se të shkonte në llixhë, mu desh t'i premtoja se do ta mbaja tërë kohën në kokë. Frikësohet të mos rrëzohem.

**VINKOJA:** Bukur po të rri.

**EMILI:** Bën shaka ti?

**EMILI:** E pse i mbathe pantoflat?

**VINKOJA:** *(Flet në mes të gllënjave të birrës.)* Fabrika shkoi në falimentim dhe ofruan pantofla praktikisht falas. Francka e dëgjoji këtë dhe i merr për vete njëzet palë, ndërsa për mua 25. Ja, tha, 20 palë do t'i kesh për kafene, se ashtu-ashtu atje je më shumë se në shtëpi. E 5 palë do t'i kesh për t'i ndërruar nëse vjen në shtëpi të flesh! I do një palë?

**EMILI:** Jo, faleminderit.

**VINKOJA:** Me gjithë qejf t'i fal.

**EMILI:** Kur të them jo, jo!

**VINKOJA:** 20 palët nuk do t'i mbath; më parë do të shërohem! *(E ngre gotën dhe përshëndet me të.)* Ju bëftë mirë!